

FOREIGN WORDS AND EXPRESSIONS INSTEAD OF ALBANIAN WORDS

Hana Darlishta

University of Tetovo, Tetovo, North Macedonia, hana.dardhishta@unite.edu.mk

Abstract: Today, in the Albanian language (either in what is used in daily life, or in the standard language used in the country's institutions), many new or foreign words are entering as a result of the extraordinary development of information technology. Thus, we are facing new words every day, we are hearing new expressions every day. The point is that in the language are entering even words that the Albanian language does not need it, even though it has it on its own language and the use of these loanwords is unnecessary. In the period of globalization, English has become the dominant language everywhere in the world, so it falls to have risking not only the Albanian language but also other languages everywhere in the world.

In this statement, we have expressed our concern and not only, for the disdainful attitude of the Albanian language from our society, but also from institutions including schools, the media (which also in some way, language education also comes through the media), not leaving out social media.

Our focus in this process will be the media and social networks, because, young people are the first to be exposed to social changes. The language needs care, also for an organized institutional attention that will deal with today's problems.

Keywords: Albanian language, media, society, neglect, loans.

FJALË DHE SHPREHJE TË HUAJA NË VEND TË FJALËS SHQIPE

Hana Dardhishta

Universiteti i Tetovës, hana.dardhishta@unite.edu.mk

Përmbledhje: Sot, në gjuhën shqipe (qoftë në atë që përdoret në jetën e përditshme, qoftë në gjuhën standarde që përdoret në institucionet e vendit) po vërshojnë një mori fjalësh të reja apo të huaja si pasojë e zhvillimit të jashtëzakonshëm të teknologjisë së informacionit. Kështu, ne për çdo ditë po ballafaqohemi me fjalë të reja, për çdo ditë po dëgjojmë shprehje të reja. Çështja qëndron në atë se në gjuhë po depërtojnë edhe fjalë për të cilat nuk ka nevojë gjuha shqipe, meqë i ka në brumin e vet dhe përdorimi i këtyre huazimeve është i panevojshëm. Në periudhën e globalizimit anglishtja është bërë gjuhë mbizotëruese kudo në botë, kështu që i bie të ketë rrezikuar jo vetëm gjuhën shqipe po edhe gjuhë të tjera kudo nëpër botë.

Në këtë kumtesë kemi shprehur shqetësimin tonë dhe jo vetëm, për qëndrimin mospërfillës ndaj gjuhës shqipe nga vetë shoqëria jonë, gjithashtu edhe nga institucionet përfshirë këtu shkollat, mediet (që gjithashtu në njëfarë mënyre, ditëve të sotme, edukimi gjuhësor vjen edhe nëpërmjet medieve), duke mos lënë anash edhe rrjetet sociale. Fokusi ynë në këtë trajtesë do të jenë mediet dhe rrjetet sociale, meqë, ndryshimeve shoqërore së pari u ekspozohen të rinjtë. Gjuha ka nevojë për përkujdesje, gjithashtu edhe për një vëmendje institucionale të organizuar, që do të merret me problemet e sotme.

Fjalë kyçe: gjuhë shqipe, medie, shoqëri, shpërfillje, huazime.

1. HYRJE

Gjuha si mjet komunikimi është krijuar së bashku me njeriun. Gjuha gjithashtu vazhdimisht zhvillohet, që nënkupton edhe ndryshimet në të gjitha sferat e jetës, si në veprimtarinë shoqërore, kulturore, shkencore etj., të shoqërisë që e flet po atë gjuhë. Pra, gjuha është në një proces zhvillimi edhe atë të vazhdueshëm dhe po ky proces i ndryshimeve gjuhësore përveç që ndikon në përbërjen e leksikut të gjuhës, gjithashtu drejtpërdrejt pasqyrohet në fjalor, pra në leksik. Për këto prurje të reja toleranca është e domosdoshme sepse çdo gjuhë, çdo komunikim është në zhvillim e sipër. Këtë zhvillim apo këtë rritje ne nuk mund ta ndalojmë sepse ato vijnë bashkë me risitë zhvillimore të kohës, si teknologjitë e informacionit, ato tekniko-shkencore etj. Vërsimi i fjalëve dhe shprehjeve të huaja në gjuhën shqipe na bën të mendojmë pak më shumë rreth historikut të gjuhës sonë. Populli shqiptar ndër shekuj ishte nën sundime të ndryshme, megjithatë në detin e madh të popujve ne dalloheshim sepse kishim gjuhën tonë. Fakti që ne jemi sot një popull me gjuhë të veçantë nga të tjerët i detyrohet asaj që ne kemi arritur të ruajmë një gjuhë të veçantë siç është gjuha shqipe, përkundër kontaktit të drejtpërdrejtë të shqiptarëve me fqinjësi me popuj tjerë, me gjuhë të ndryshme, por edhe nën sundimin e të tjerëve. Pikërisht kjo gjuhë na ka dhënë identitetin si popull. Gjuha shqipe është mjeti që na lidh të gjithë shqiptarëve pavarësisht se ku jetojmë, pra si të thuash është një emërues i

përbashkët. Gjuha dhe përdorimi i saj në mënyrën e duhur gjithashtu është një përgjegjësi kombëtare. Por, a flitet dhe shkruhet siç duhet, sa janë të saktë në të folurën e tyre shqiptarët dhe në veçanti brezat e rinj, të cilët po tregojnë një shpërfillje të pafalshme ndaj gjuhës. Të rinjtë kanë filluar të flasin një shqipe me theks anglez, që do të thotë se prish modelet e trashëguara të theksimit të fjalëve në gjuhën shqipe. Tendenca e të rinjve që të përdorin më shumë fjalë të huaja vjen nga trysnia e informacionit nga gjuha e huaj. Zhvillimi i teknologjisë, komunikimi digjital, interneti me rrjetet e tij sociale, televizioni, radio e shumë forume të tjera, me një fjalë mediet, kanë funksion dominues. Kështu në njëfarë mënyre globalizimi ka bërë të mundshme formimin e një hapësire globale informacioni, ku mediet e mëdha botërore ndikojnë tek mediet e mbarë botës (nëpërmjet formave të ndryshme të transmetimit të informacionit). Këtu do të ndërlidheshin me studiuesin Qemal Murati i cili kur flet për gjuhën në medie thekson se: "njeriu e ka ushqim të përditshëm informacionin, medie të shkruara, medie televizive, medie elektronike, faqe uebi etj., prodhojnë pandërprerë fjalë e fjali stereotipe..., të cilat degjenerohen, automatizohen si shprehje të tilla të kalkuara keq sidomos nga anglishtja" (Murati, 2013: f. 239). Pra, media padyshim që ndikon te folësi, mënyra se si folësi flet, duke patur parasysh përparimin e shpejtë të teknologjisë edhe njerëzit fillojnë e përshtaten me ndryshimet edhe duke marrë apo duke "huazuar" fjalë të gatshme.

2. MATERIALE DHE METODA

Për të realizuar këtë punim apo këtë trajtesë kemi përdorur metodën përshkruese, krahasuese dhe analizuese. Mediet dhe rrjetet sociale (aty ku një pjesë bukur e mirë e të rinjve kalojnë kohën) janë një burim i mirë i materialit tonë të cilin edhe e kemi elaboruar me anë të shembujve të ndryshëm duke bërë edhe krahasimin e tyre nga gjuha e huaj me mënyrën e duhur të shqipes standarde.

3. TRAJTIMI I TEMËS DHE REZULTATET

Depërtimi i fjalëve të huaja në një gjuhë zakonisht bëhet nëpërmjet leksikut. Zhvillimi i teknologjisë, gjithashtu edhe komunikimi digjital ka bërë që sot media të jetë mbizotëruese në diskursin publik. Fjalët e huaja (kryesisht anglicizmat) të përdorura në gjuhën shqipe shihen si ndërhyrje arbitrare në gjuhë. Në këtë punim gjuhësia mediatike na shërben për të vlerësuar situatën e përgjithshme të gjuhës shqipe në mediet shqiptare. Sipas studiuesit K. Berdimurodovic "Shumë më e rëndësishme për një person mesatar nuk është sasia e njohurive të marra në familje, shkollë apo kolegji, por ajo që ai dëgjon në radio, shikon në TV ose në filma, lexon në një poster ose gazetë, mëson nga bisedat me kolegët dhe fqinjët (Berdimurodovic, 2022: f. 2142). Mjafton të përmendim që përveç TV, këtu kanë funksion dominues edhe interneti me rrjetet e tij sociale, forumet e blogjet e ndryshme. Kësisoj, sipas studiuesit Richard Butsch "kultura e ekranit" përkufizohet si media që "ka të bëjë më shumë me imazhet sesa me gjuhën, e që është një formë moderne e kulturës vizuale" (Kortti, 2020: f. 713-714). Media ndikon tek folësi me fjalë a terma të ndryshëm, por edhe me shprehje. Sot kjo gjuhë dhe jo vetëm është e rrezikuar nga ndikimi i gjuhëve të huaja, sepse pjesa më e madhe e huazimeve dëshmojnë se kemi të bëjmë me fjalë të cilat gjuha shqipe i ka në fjalorin e saj dhe kështu i bie të bëjmë me dysorë (dublete). Si dysorë në vijim do të paraqesim shembujt, si: shlyerje – likuidim (shlyerje e llogarisë – likuidim i llogarisë), stinor – sezonal (çmim stinor - çmim sezonal), e ligjshme – legale (firo e ligjshme – firo legale) etj. që në njëfarë mënyre po shkatërron strukturën e gjuhës sonë. Gramatika fillon e shkatërrohet atëherë kur shikon që mënyra e formimit të fjalive fillon e ndryshon, sidomos në mënyrën e rendit të fjalëve në fjali. Pra, thelbi i gjuhës është sistemi gramatikor. Folësit televiziv, që njëherit kanë shumë ndikim tek popullata, për momentin janë një shembull jo i mirë. Çështja se si shkruhen këto fjalë gjithashtu është çështje më vete. Në vijim do t'i paraqesim disa nga shqetësimet tona me të cilat ballafaqohemi nga të gjitha anët, si:

1. Theksi i emrave të përveçëm – vërejmë një shqiptim të emrave me theks të ndikuar nga anglishtja.
2. Mosnjohja e gjuhëve të huaja shkakton gabime gjatë leximit apo gjatë prezantimit të lajmeve të ndryshme në medie, siç kemi rastet ku disa prezantues nuk dinë të dallojnë anglishten nga gjermanishtja, si, shkronja w - dabëllju në gjuhën gjermane lexohet w, ndërsa në gjuhën angleze lexohet uo, p. sh. Walteri në gjermanishte kemi Valteri, ndërsa prezantuesi e lexon si në anglishte Uolter, apo markën e veturave Volkswagen (që në gjuhën gjermane shkronja V lexohet F, pra Folksvagen, ndërsa prezantuesi e lexon apo e shqipton me V. Sa i përket gjuhës turke, ajo ka shkronjën ğ që gjatë të lexuarit nuk lexohet fare, si tek emri Erdoğan. Kështu, në prezantimin e lajmeve kuptojmë që prezantuesit nuk arrijnë dot ta mësojnë se emri i presidentit të Turqisë shqiptohet Erdoan e jo Erdogan. Pra, përveç njohjes së gjuhëve të huaja, përmirësimi i gjuhës kërkon edhe përmirësimin e kulturës së të menduarit.
3. Respektimi i gjuhës së shkruar lë shumë për të dëshiruar. Gati në çdo fjali vërejmë që nuk bëhet lakimi i emrave, sidomos i emrave të përveçëm, p. sh. *Rama takon Merkel* (duhet: *Rama takon Merkelin*), apo shembulli në vijim, si: *Këto deklarata të Tramp...* (duhet: *Këto deklarata të Trampit*) etj. (Regjistrime nga televizione të ndryshme si nga vendi ashtu edhe jashtë vendit, pra, përfshirë këtu edhe televizionet shqiptare nga Kosova ashtu edhe nga Shqipëria).

4. Lëshimet rreth përdorimit të shkronjës *ë*. Duke pasur parasysh që gjuha shqipe e ka këtë fonemë në alfabetin e gjuhës, duhet respektuar si në të folur ashtu edhe në të shkruar. Shpesh herë na rastis që të shohim tituj lajmesh që janë të shkruara të gjitha me fonemën *e*, duke u arsyetuar me faktin se është e kuptueshme, p. sh. *Lajmet e ores 11:00* (@teve1, 20.07.2024, <https://teve1.info>).
5. Leksiku i huaj apo fjalë të huaja (vjelja apo përmbledhja e këtij leksiku është regjistruar nga bisedat e ndryshme në emisione të ndryshme televizive) në vend të fjalëve shqipe, si:
 - Abrogoj – shfuqizoj, p. sh. *Ne do ta abrogojmë Ligjin për arsimin e lartë*; adekuate – përkatëse; akses (access) – fjalë që ka më shumë kuptime, në varshmëri të kontekstit të fjalisë kemi edhe fjalët e duhura në gjuhën shqipe, si: qasje, hyrje, arritje, kapje, p. sh. *Kjo rrugë nuk është e aksesueshme* – kjo rrugë është e pakalueshme, apo shembulli në vijim, si: *nuk kam akses në internet* – që në shqip shumë më lehtë mund të shprehemi, vetëm: *nuk kam internet ose nuk kam qasje në internet*; aprovoj – miratoj; avangard – pararoj; azhurnoj – nga frëngjishtja me kuptimin përditësoj, tani së fundmi edhe *abdejt* (*update*), kjo nga anglishtja dhe që përdoret me po të njëjtin kuptim përditësoj, p. sh. Bëj një abdejt telefonit (duhet: Përditësoje telefonin); bazike – themelore; benefite – përfitime; brutal – i vrazhdhtë; bekgraud (background) – është fjalë që dëgjohe shpesh e që duhet shmangur meqë kemi fjalët e duhura në gjuhën shqipe, me kuptimet: prapaskenë, prapavijë, sfond; eksperiencë – përvojë, p. sh. *Po eksperiencia e punës e bën të veten*; event – ngjarje, ndodhi, një organizim; evitohet – shmang; frendli (friendly) – në mënyrë shoqërore, p.sh. *Me të sillem friendly*; gjeneralizim – përgjithësim; impenjim, impenjativ – përkushtim, përkushtues, p. sh. *...është impenjativ, por nga feedback-u që po marrim ...* (komunikim i dy të rinjve në një emision televiziv); implikim (fjalë latine), involvim (fjalë angleze) – përfshirje, i përfshirë; influencë – ndikim; intervenoj – ndërhyj; investigim, investigues – hulumtim, hulumtues; justifikim – arsyetim; komplikim – ndërlikim; konkluzion – përfundim; konsolidim, p. sh. *Është konsoliduar – është dakordësuar, ka ra në ujdi*; kuantitet – sasi; kurioz – kureshtar; manual – udhëzues; memorje – kujtesë; mesazh – porosi; pastiçeri – ëmbëltore; preferoj – parapëlqej; prezent – i pranishëm; primare – parësore; progres – përparim, p. sh. *Ka një progres – ka një përparim*; rimejk (remake) - ribërje, rikrijim p. sh. *Kam bërë një rimejk të kësaj kënge*; risërc (research) – kërkim; sekondare – dytësore; sekret (secret) - fshehtësi; skip – kapërceje, kaloje, p. sh. *Bëji skip asaj që thash*; special – i veçantë; surprizë (surprise) – befasi; tentoje – u përpoq, u orvat, u mundua etj.; trend – e kohës, e modës etj.

Të gjitha këto raste e shembuj që i cekëm më lartë, mund t'i dëgjojmë dhe t'i shohim në të gjitha mediet, që do të thotë se kanë hyrë jo vetëm në të folurën individuale por edhe në atë institucionale, pra dhe në të folurën zyrtare. Në të folurën shoqërore kanë hyrë edhe fjalë të tjera që janë edhe më të panevojshme. Por ne vazhdojmë të trajtojmë fjalët e huazuara që përdoren pa përshtatjen e tyre duke mos marrë parasysh strukturën fjalëformuese të shqipes. Kështu na paraqiten problematika fonetike e gjithashtu edhe drejtshkrimore. Kemi të bëjmë me kategori të fjalëve dhe shprehjeve të huaja, të cilat mund t'i gjejmë në gjuhën shqipe dhe t'i përshtasësh më së miri, siç kemi fjalën e huaj të panevojshme *perfekt, perfeksion* (perfect, perfection) – të cilën e dëgjojmë nga të gjitha anët, ndërsa nga ana tjetër kemi dy sinonime në gjuhën shqipe për të njëjtën fjalë, si: *i përkryer dhe i përsosur*, që janë fjalë shumë të bukura të gjuhës shqipe, p. sh. në vend të: *je perfekt* – duhet: *je i përkryer* apo *je i përsosur*. Gjithashtu tani më rrallë mund ta dëgjosh dikë të thotë fjalën shqipe *fundjavë*, më shumë dëgjohe fjalë e huaj *vikend* (*weekend*), apo në vend se të dëgjosh fjalën shqipe *shfaqje* do dëgjojmë *shou* (*show*), për *markë* thuhet *brend* (*brand*), për *publik* thuhet *audiencë* (*audience*), për *sfond* thuhet: *bekgraud* (*background*), për: *para në dorë* thuhet: *kesh* (*cash*), për *e drejtë e autorit* thuhet: *kopirajt* (*copyright*). Përfshirja e fjalës *kopirajt* në FGJSSh (botim i vitit 2006) sipas meje është e panevojshme, biles përbën një gabim serioz pikërisht për faktin që gjuha shqipe i ka fjalët dhe shprehjet e duhura rreth kësaj fjale (shembull: *copyright violation* – shkelje e të drejtës së autorit; *copyright regulation* – rregullore për të drejtat e autorit etj.). Pastaj për *ekran* thuhet: *skrin* (*screen*), për *thashetheme* thuhet: *gossip* (*gossip*) etj.

Eksperimentet gjuhësore vazhdojnë çdo ditë në të gjitha fushat. Sot jetojmë në një treg të lirë dhe suksesi arrihet duke shitur, kështu për të pasur vëmendjen e publikut, duhet të dish të shesësh, si reklamta, modën, informacionin, muzikën dhe çfarëdo lloj reklame tjetër. E folura e atyre që shesin është plot e përplot me risi, si në shembujt në vijim: sivjet janë më *avangard*, më *novatore...*; modelet për të qenë *in*; çanta *handmade*; një *brand* special; *sorry*; *tendencia* tregon *street style* apo *fashion influencer*; përzjerje e stilit apo *mix and match*; Sa easy është kjo rrugë? (në vend të fjalës së huaj *easy* duhet: *e lehtë*), apo shembujt në vijim: 80% e *users*(*ave*) të tik tokut janë.... (në vend të fjalës së huaj *users* mund të përdoret fjala shqipe *përdoruesit* apo *abonuesit* e tik-tokut); Po ta them kështu për të qenë riëll (*real*) me ty (duhet: Po ta them kështu për të qenë *e realtë* me ty). Kështu të gjitha këto fjalë merren dhe përdoren në jetën e përditshme dhe ne fillojmë e harrojmë fjalët shqipe dhe marrim e përdorim fjalët e një gjuhe tjetër pa qenë nevoja . Gradualisht fjalët e gjuhës shqipe fillojnë e bien në fondin pasiv të gjuhës dhe kështu dalëngadalë fillojnë e harrohen apo më mirë thënë bien në harresë.

6. Shprehje të huaja në vend të shprehjeve shqipe, si:
 - Castor oil - nga anglishtja: *vaj kastori* (fjala *vaj* është përkthyer në gjuhën shqipe, por në mungesë informacioni se çfarë mund të jetë *castor*, nuk është përkthyer fare dhe është marrë i njëjti term nga anglishtja, e që në gjuhën shqipe duhet të jetë *vaj ricini* (kjo nga latinishtja: *Ricinus communis*, shqip: *ricini*). Për këtë term në gjuhën shqipe ekzistojnë edhe emërtime tjera, të cilat populli i ka përdorur më herët, si: *bari i ujit*, *bari i ujthit*, *mertiku*, *mërtiku*, *qiqi*, *recina* etj. (Lloshi, 2010: f. 283). Tani, nga përdorimi i shpeshtë që ka kjo shprehje: *vaj kastori* është më e kuptueshme për përdoruesit se sa shprehja *vaj ricini*, e gjithë kjo ngaqë na pëlqen t'i marrim gjërat e gatshme nga gjuhë të tjera edhe aty ku nuk është nevoja. Mendoj dhe gjithashtu do të vazhdoj ta bërtas këtë çështje, që, është mëkat të përdoren fjalë apo shprehje të huaja aty ku gjuha shqipe ka fjalën apo shprehjen e vet.
 - Best seller – nga anglishtja (shitja më e mirë), si p. sh. Ju mirëpresim në gjashtë ekspozitat *best seller*.
 - Best new artist – gjithashtu është një shprehje nga gjuha angleze, p. sh. *Për çmimin «Best new artist» ka vendosur juria* (duhet: *Për çmimin «Artisti më i mirë i ri» ka vendosur juria*).
 - Dancing with the stars – edhe një shprehje angleze, njëkohësisht edhe si program i titulluar po me këtë shprehje, e që mund të titullohej edhe në gjuhën shqipe «Të kërcejmë me yjet».
 - Social media – edhe këtë shprehje angleze e dëgjojmë shumë shpesh në vend të shprehjes në gjuhën shqipe: mediet apo rrjetet sociale.
 - Happy end – këtë shprehje më së shumti e dëgjojmë kur flitet për një përfundim të gëzuar, p. sh. *Mbaroi filmi me hepi end!*
7. Fjalë dhe shprehje në gjuhën shqipe, por të ndërtuara nën ndikimin e gjuhës angleze, si:
 - Brainstorm – e përkthyer si *stuhia mendimesh* dhe që përdoret po me këtë shprehje. Nuk ka nevojë që të bëhet një përkthim i fjalëpërfjalshëm, sepse ne gjatë gjithë jetës tonë kemi përdorur fjalitë: *rrahje mendimesh*, e që në kohët më të hershme është përdorur fjala *pleqërojmë*, por që tani është zëvendësuar me shprehjen *rrahje mendimesh*.
 - Paç një *vikend* të mbarë (ose të këndshëm), kjo nga gjuha angleze: *Have a nice weekend!*, edhe këtu përveç shprehjes me ndikim nga anglishtja, kemi edhe përdorimin e fjalës së huaj *vikend* në vend të fjalës shqipe *fundjavë* (që ndodh edhe tek gjuhët e tjera, si për shembull: *Have a nice day!*, në gjuhën maqedonase: *Имај убава ден!*).
 - Ky problem duhet adresuar – kjo nga anglishtja: *This problem need to adress*. Në gjuhën shqipe nuk është nevoja të thuhet një shprehje e tillë, sepse në shqipe fare lehtë e qartë mund të thuhet: *Ne duhet të merremi me këtë problem (për ta zgjidhur)*.

Këto tendenca dhe shumë të tjera janë aty dhe kjo tregon që gjuhët zhvillohen, pasurohen dhe ndryshohen gjatë gjithë kohës. Shqiptarët duhet të vetëdijësohen për këto çështje dhe të kenë kujdes që të mos zënë vend këto fjalë në gjuhën shqipe. Zotërimi i mirë i gjuhës shqipe vetvetiu përjashton fjalët e panevojshme.

4. PËRFUNDIM

Sot, në gjuhën shqipe qoftë problemi i mospërkthimit të fjalëve të huaja, qoftë problemi i huazimeve të panevojshme është një situatë mjaftë shqetësuese. Çështja që ne nuk po tregojmë kujdesin e nevojshëm për gjuhën shqipe është rreziku i vërtetë për një dukuri që është e hapur. Profesor Rami Memushaj në një shkrim të tijin do të shprehej: "Gjuha duke qenë mjeti themelor për shprehjen e kulturës, përbën, edhe një nga përmasat themelore të saj. Roli i gjuhës rritet edhe më shumë në kuadrin e integritetit evropian. Por, në kushtet e një shoqërie të hapur gjuha ndodhet para të njëjtave rreziqe dhe probleme si edhe nga kultura që ajo bart." (Memushaj, 2012). Ashtu siç në të kaluarën kishte kujdes ndaj gjuhës dhe largoheshin shumë fjalë turke e të tjera dhe zëvendësoheshin me fjalë shqipe apo përshtateshin fjalë të reja, edhe sot duhet të bëhet e njëjta. Një gjuhë që i plotëson funksionet e veta të komunikimit nuk ka nevojë të ndryshohet apo të plotësohet nga fjalë të gjuhëve tjera. Ndonjëherë edhe paraqitet nevoja për huazim, por vetëm në të tilla raste ku gjuha shqipe nuk ofron fjalë të përshtatshme (medoemos që janë huazuar fjalë edhe në të kaluarën dhe mund të huazohen edhe sot dhe gjithashtu edhe në të ardhmen), pra raste ku duhet detyrimisht të huazojmë, ngaqë nuk mund të gjendet fjala e përshtatshme që e mbart mjaftueshëm mirë kuptimin e fjalës së huaj, por jo aty ku nuk paraqitet nevoja. Sa i përket këtij punimi që ka të bëjë me prurjet e panevojshme nuk është shterues, por shpresoj që kjo qasje të shërbejë sado pak si shembull, sidomos për të rinjtë dhe ata të cilët punojnë në institucione të ndryshme dhe kanë ndikim në masën e gjerë.

Për fund do të thosha që folësit duhet të jenë të lirë në zgjedhjen e fjalëve që gjatë ligjëritimit të tyre të mund të përputhin saktë mjetin ligjërimor me situatën komunikuese. Fjalët e huaja vijnë e përthithen natyrshëm, është proces vetëdijësimi, kulturimi që me anë të leximit, e më shumë me anë të mësimin dhe sigurisht me një sistem edukimi të shëndoshë besoj që kështu ne do të jemi të mbrojtur ndaj të huajës, sepse gjuhët dhe kulturat nuk mund të mbeten të mbyllura.

BURIMET

- Berdimurodovic, K. (2022). *Media Linguistics and Its Role in The Language of Modern Mass Media*, International Journal for Research in Applied Science and Engineering Technology, 10 (IV).
- Cook, V. (1991). *Second language learning and language teaching*, London.
- Çano E., & Tupja E. (2022). *Terminologji informatike: Problematika dhe Zgjidhje*, Tiranë.
- Fjalor i shqipes së sotme*. (1984). Instituti i gjuhësisë dhe i letërsisë, Tiranë.
- Gardner, H. (2006). *Multiple intelligences: New horizons*., N. Y.: Basic Books.
- Gerard, F. M. (2003). *Hartimi dhe vlerësimi i teksteve shkollore*, Tiranë.
- Kortti, J. P. (2020). *Screen Culture: A global History*. By Richard Butsch, *Journal of Social History*, Volume 54, Issue 2.
- Lloshi, Xh. (2021). *Vështrime stilistike*, Tiranë.
- Lloshi, Xh. (2022). *E duam drejtshkrimin si gjithë Europa*, Shkup.
- Memushaj, R. (2011). *Shqipja standarde, si ta flasim dhe ta shkruajmë*, Botimet Toena, Tiranë.
- Memushaj, R. (2012). *Politikat gjuhësore në epokën e globalizimit*, Gazeta “Shqip”, Tiranë.
- Murati, Q. (2013). *Gjuha shqipe në komunikimet publike*, Instituti Albanologjik, Prishtinë.
- Thomai, J., Samara, M., Haxhillazi, P., Shehu, H., Feka, Th., & Memisha, V. (2020). *Fjalor i gjuhës shqipe*, Tiranë.
- Xhuvani, A. (2020). *Fjalor i gjuhës shqipe*, Tiranë.